

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
AGRIMONA SH.P.K.**



Sot më datë 12 Janar 2018, palët e mëposhtme:

- **Znj. Rozina Marku**, qytetare shqiptare, lindur në Gojan i Vogël, Pukë, Shqipëri, më 01.07.1972, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. H25701175H, me banim në Rrugen Cerciz Topulli, Pl. AK, Shk. 5/1, Tirane, Shqipëri.
dhe
- **Zj. Sonila Marku**, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, Shqipëri, më 15.09. 1996, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. J65915067S, me banim në Rrugen Cerciz Topulli, Pl. AK, Shk. 5/1, Tirane, Shqipëri.
dhe
- **Z. Shkëlzen Marku**, qytetar shqiptar, lindur në Porav-Fierzë, Pukë, Shqipëri, më 11.07.1969, mbajtës i kartës së identitetit me nr. G9071106F, banues në Rruga "Çerçiz Topulli", AK", Shk. 5/1, Tiranë, Shqipëri,

në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" i ndryshuar, dhe legjislacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi kanë vendosur të themelojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar **AGRIMONA Sh.p.k.** Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkalidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur **AGRIMONA Sh.p.k** (këtej e tutje referuar edhe si "**Shoqëria**").
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga e Bogdanëve, Pl. 13/4a, Ap. 10, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë, transferojë dhe/apo mbyllë, shoqëri të kontrolluara, degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi, si dhe çfarëdolloj entiteti tjetër të çdo lloji në Shqipëri apo jashtë saj.

Neni 3 - Kohëzgjatja

- 3.1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Objekti i aktivitetit ekonomik të Shoqërisë është grumbullimi, përpunimi, marketingu dhe shitja e produkteve bujqësore dhe ushqimore dhe shërbimeve të lidhura me to, përfshirë importin dhe eksportin e këtyre produkteve, si dhe të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me ose plotësojnë, direkt apo indirekt, aktivitetin e mësipërm.



- 4.2 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të përfitojë, direkt apo indirekt, pjesëmarrje në shoqëri, ndërmarrje, agjenci dhe sipërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë një objekt aktiviteti të ndryshëm.
- 4.3 Shoqëria do të operojë si një "biznes social" në përputhje me parimet dhe praktikatat e mira të biznesit social në Europë dhe Shqipëri. Në veçanti, Shoqëria do të veprojë në bazë të misionit të saj social dhe në mënyrë financiarisht të qëndrueshme, ku asnjë prej fitimeve të Shoqërisë nuk do të përdoret për përfitimin personal të ortakëve të saj, përveç pagesave për punën e kryer prej tyre dhe rimbursimit të shpenzimeve të lidhura me ato, por se do të përdoret për realizimin e përfitimeve sociale të mëtejshme. Investimi fillestar apo investime të tjera të mëvonshme mund t'u rikthehen ortakëve apo investitorëve sipas marrëveshjeve përkatëse. Çdo e ardhur tjetër do të mbahet nga Shoqëria, do të ri-investohet në Shoqëri për zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit ose do të përdoret për financimin e aktiviteteve në mbështetje të realizimit të objektivave sociale të shoqërisë.
- 4.4 Misioni social i Shoqërisë është rritja e punësimit dhe të ardhurave të familjeve rurale dhe periurbane në Shqipëri, veçanërisht grave dhe të rinjëve, si dhe promovimi i mbrojtjes së mjedisit dhe praktikave të qëndrueshme të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve agroushqimore në Shqipëri.
- 4.5 Gjithashtu, për të realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj transaksioni lidhur me shitblerjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qeraje apo hipotekimi që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim me objektin e Shoqërisë.

Neni 5 – Kapitali themeltar


- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1,000 Lekë (një mijë Lekë), i përbërë nga 3 (tre) kuota, secila prej tyre me një vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin e Shoqërisë. Kapitali mund të shlyhet me kontribute në para dhe/ose kontribute në natyrë.
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
- Znj. Rozina Marku, që ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 400 Lekë (katërqind Lekë); dhe
 - Zj. Sonila Marku, që ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 200 Lekë (dyqind Lekë); dhe
 - Z. Shkelzen Marku, që ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 400 Lekë (katërqind Lekë).
- 5.3 Duke u bazuar në kontributet e mësipërme:
- Znj. Rozina Marku zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 400 Lekë (katërqind Lekë), e cila përfaqëson 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
 - Zj. Sonila Marku zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 200 Lekë (dyqind Lekë), e cila përfaqëson 20% (njëzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë;
 - Z. Shkelzen Marku zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 400 Lekë (katërqind Lekë), e cila përfaqëson 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Article 6 – Transferimi i Kuotave


Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.

Article 7 – Administratori

- 7.1 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë, për një periudhë prej 3 (tre) vitesh:



2

- 
- Znj. Rozina Marku, qytetare shqiptare, lindur në Gojan i Vogel, Pukë, Shqipëri, më 01.07.1972, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. H25701175H, me banim në Rrugen Cerciz Topulli, Pl. AK, Shk. 5/1, Tirane, Shqipëri.

7.2 Administratori përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.

7.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("*ad negotia*") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.

7.4 Administratori është, gjithashtu, i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është, gjithashtu, i autorizuar të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 8 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe.

Neni 9 – Dispozita të Fundit


Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

NË DËSHMI TË SA MË SIPËR, Palët deklaruan se ky Akti Themelimi dhe Statuti bashkangjitur si Shtojca A, është në përputhje me vullnetin e tyre dhe për këtë arsye e nënshkruan atë në datën e sipërsëhënuar, me vullnet të plotë dhe të lirë, dhe unë Noterja, vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit.

ORTAKU




Znj. Rozina Marku




ORTAKU




Zj. Sonila Marku



ORTAKU



Z. Shkelzen Marku



SHTOJCA A

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR AGRIMONA SH.P.K.

KAPITULLI I EMËRTIMI, SELIA, KOHËZGJATJA DHE OBJEKTI

Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "AGRIMONA Sh.p.k". (këtë e tutje referuar edhe si "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Selia


- 2.1 Selia e Shoqërisë është në Rruga e Bogdanëve, Pl. 13/4a, Ap. 10, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë, transferojë dhe/apo mbyllë, shoqëri të kontrolluara, degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi, si dhe çfarëdolloj entiteti tjetër të çdo lloji në Shqipëri apo jashtë saj.

Neni 3 - Kohëzgjatja


- 3.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2 Shoqëria mund të priset në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 – Objekti

- 4.1 Objekti i aktivitetit ekonomik të Shoqërisë është grumbullimi, përpunimi, marketingu dhe shitja e produkteve bujqësore dhe ushqimore dhe shërbimeve të lidhura me to, përfshirë importin dhe eksportin e këtyre produkteve, si dhe të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me ose plotësojnë, direkt apo indirekt, aktivitetin e mësipërm.
- 4.2 Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të përfitojë, direkt apo indirekt, pjesëmarrje në shoqëri ndërmarrje, agjenci dhe sipërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë një objekt aktiviteti të ndryshëm.
- 4.3 Shoqëria do të operojë si një "biznes social" në përputhje me parimet dhe praktikën e mira të biznesit social në Europë dhe Shqipëri. Në veçanti, Shoqëria do të veprojë në bazë të misionit të saj social dhe në mënyrë financiarisht të qëndrueshme, ku asnjë prej fitimeve të Shoqërisë nuk do të përdoret për përfitimin personal të ortakëve të saj, përveç pagesave për punën e kryer prej tyre dhe rimbursimit të shpenzimeve të lidhura me ato, por se do të përdoret për realizimin e përfitimeve sociale të mëtejshme. Investimi fillestar apo investime të tjera të mëvonshme mund t'u rikthehen ortakëve apo investitorëve sipas marrëveshjeve përkatëse. Çdo e ardhur tjetër do të mbahet nga Shoqëria, do të ri-investohet në Shoqëri për zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit ose do të përdoret për financimin e aktiviteteve në mbështetje të realizimit të objektivave sociale të shoqërisë.
- 4.4 Misioni social i Shoqërisë është rritja e punësimit dhe të ardhurave të familjeve rurale dhe periurbane në Shqipëri, veçanërisht grave dhe të rinjve, si dhe promovimi i mbrojtjes së mjedisit dhe praktikave të qëndrueshme të prodhimit, përpunimit dhe tregtimit të produkteve agroushqimore në Shqipëri.
- 4.5 Gjithashtu, për të realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj transaksioni lidhur me shitblerjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar,



4



qeraje apo hipotekimi qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te saj me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundertshtim me objektin e Shoqerise.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, RRIJTA DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 5 – Kapitali themeltar

- 5.1. Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 1,000 Lekë (një mijë Lekë), i perberë nga 3 (tre) kuota, secila prej tyre me një vlerë nominale sipas kontributit të ortakëve në kapitalin e Shoqerise. Kapitali mund të shlyhet me kontribute në para dhe/ose kontribute në natyrë.
- 5.2. Kapitali themeltar i Shoqerise eshte nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
- Znj. Rozina Marku, qe ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqerise në shumën prej 400 Lekë (katërqind Lekë); dhe
 - Zj. Sonila Marku, qe ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqerise në shumën prej 200 Lekë (dyqind Lekë); dhe
 - Z. Shkelzen Marku, qe ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqerise në shumën prej 400 Lekë (katërqind Lekë).
- 5.3 Duke u bazuar në kontributet e mesiperme:
- Znj. Rozina Marku zoteron 1 (një) kuota, e barabartë me 400 Lekë (katërqind Lekë), e cila përfaqëson 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqerise;
 - Zj. Sonila Marku zoteron 1 (një) kuota, e barabartë me 200 Lekë (dyqind Lekë), e cila përfaqëson 20% (njëzet përqind) të kapitalit themeltar të Shoqerise;
 - Z. Shkelzen Marku zoteron 1 (një) kuota, e barabartë me 400 Lekë (katërqind Lekë), e cila përfaqëson 40% (dyzet përqind) të kapitalit themeltar të shoqerise.

Neni 6 – Rritja e kapitalit themeltar

- 6.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 6.2 Në rast rritje kapitali të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në Shoqeri. Në rast se disa nga ortakët heqin dorë nga kjo e drejtë, pjesa e panënshkruar e kapitalit mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë në përpjesëtim me pjesët që ata zotërojnë në kapital. Në rast se asnjë apo disa nga ortakët nuk e nënshkruajnë rritjen e kapitalit, kapitali i rritur i panënshkruar është subjekt i nënshkrimit nga palë të treta.
- 6.3 Kapitali nuk mund të zmadhohet për sa kohë nuk është përmbushur detyrimi për të paguar kuotat e nënshkruara më parë.

Neni 7 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 7.1 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të zvogëlojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 7.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 8 – Transferimi i kuotave

- 8.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, kurdo dhe siç mund të bëhet dakort me vonë mes ortakëve.
- 8.2 Në rast transferimi të plotë ose të pjesshëm të kuotave në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin, në favor

të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.

8.3 Në një rast të tillë, ortaku që do të transferojë pronësinë e kuotës së tij ose të një pjese të saj, duhet të njoftojë ortakët e tjerë, me letër rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjithë kuotës së ofruar për shitje.

8.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, apo në formë tjetër, me konfirmim me shkrim të marrjes së letrës, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotën, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.

8.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuota e ofruar nga ortaku që transferon kuotën, do të ndahet nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.

8.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

8.7 Në rast të transferimit të kuotave për shkak trashëgimie *mortis causa* ortakët e tjerë kanë të drejtë të shprehin pëlqimin e tyre për ortakët e rinj. Në rast se nuk jepet pëlqimi, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht, me vendimin pozitiv të Asamblesë së Ortakëve.

8.8 Në vend të ushtrimit të të drejtës së parablerjes, kur Kuotat e Ofruara të Ofruesit përbëjnë 70% (shtatëdhjetë përqind) ose më shumë të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, Ortaku/ët e tjerë ka/kanë të drejtë t'u bashkohen transaksionit ndërmjet Blerësit dhe Ofruesit ("E Drejta Tag-Along"):

8.8.1 Brenda afatit të ushtrimit të së drejtës së parablerjes përcaktuar në Nenin 8.4 më lart, Ortakët e Tjerë kanë të drejtë t'i kërkojnë Blerësit që t'ua blejë kuotat që ata zotërojnë në Shoqëri me anën e një njoftimi me shkrim dërguar Ofruesit apo Shoqërisë, dhe Blerësi është i detyruar t'i ofrojë një çmim për kuotë të barabartë me çmimin për kuotë treguar në Njoftimin e Transferimit.

8.8.2 Transferimi i Kuotave të Ofruara Blerësit kushtëzohet nga blerja nga ana e Blerësit edhe të kuotave të zotëruara nga Ortakët e Tjerë që e ushtrojnë Të Drejtën Tag-Along.

8.8.3 Pagesa e çmimit të blerjes duhet të kryhet për Ortakët e Tjerë që e ushtrojnë Të Drejtën Tag-Along brenda 30 (tridhjetë) ditësh pune nga data e përfundimit të afatit për ushtrimin e kësaj të drejte kundrejtë transferimit të kuotave.

8.8.4 Nëse asnjë nga apo një pjesë e Ortakëve të Tjerë nuk e ushtrojnë të Drejtën Tag-Along, Ofruesi vijon me transferimin e kuotave tek Blerësi në përputhje me kushtet e Njoftimit të Transferimit, rast ky i cili nuk do të ndikojë në Të Drejtën Tag-Along të Ortakëve të Tjerë, nëse kanë, që nuk e ushtrojnë atë.

8.9 Ndalohet krijimi i të drejtave reale mbi kuotat e Shoqërisë me qëllim garantimin e detyrimeve të një palë të tretë, me ose pa pagesë, përveçse kur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme parashikohet ndryshe.

KAPITULLI III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 9 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

9.1 Organi vendimmarrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

9.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimin e shkarkimin e Administratorëve, ekspertëve kontabël e likuiduesve, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, transferimin e kuotave, riinvestimin e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë, miratimin e bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga legjislacioni përkatës apo nga ky Statut



- 9.3 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të krijojë një Këshill Konsultativ. Këshilli Konsultativ do të kryejë funksionet e një organi këshillimor për administratorët e Shoqërisë në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në vendimin përkatës së Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 10 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës


- 10.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamblesë e Përgjithshme, të shpreh mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë.
- 10.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person i pajisur me prokurë me shkrim, i cili nuk duhet të jetë domosdoshmërisht një ortak tjetër. Në çdo rast, prokura mund të jetë vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e vlefshme për thirrjen e parë dhe të dytë të saj.
- 10.3 Ortaku nuk mund të autorizojë asnjë përfaqësues për të votuar për një pjesë të kuotave që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë, ndërsa voton personalisht për pjesën e mbetur të tyre.

Neni 11 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e inventarit dhe bilancit, të raportit të Administratorit/ëve, si dhe raportin e ekspertit kontabël (nëse është emëruar).
- 11.2 Asambleja Përgjithshme thirret nga Administratori/ët ose nga një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja e Përgjithshme duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande apo formë tjetër me kthim përgjigje apo mesazh elektronik me evidencë marrje, dërguar ortakëve – në adresën që rezulton në Regjistrin e Ortakëve – dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike përpara mbledhjes. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë së Përgjithshme, rendin e ditës, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 11.3 Asambleja Përgjithshme mund të mbledhet edhe në një vend tjetër të ndryshëm nga selia e Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë shtetit.
- 11.4 Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 11.7 të këtij Statuti, Asambleja e Përgjithshme do të thirret sërish brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 11.5 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahen edhe nëpërmjet audio apo video-konferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen nga Kryetari dhe kanë mundësinë të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në të; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.
- 11.6 Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e thirrur dhe zhvilluar rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të gjithë kapitalin themeltar dhe të gjithë ortakët janë dakord të vijojnë me mbledhjen pavarësisht parregullsive të njoftimit.
- 11.7 Asambleja e Përgjithshme vendos për ndryshimet e Statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shkarkimit të Administratorit/ëve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë me votën pro të ortakëve pjesëmarrës që përfaqësojnë të paktën 80% (tetëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Përgjithshme merr vendimet në mbledhje të zakonshme me votën pro të ortakëve që përfaqësojnë 51% (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.
- 11.8 Pavarësisht nga sa më sipër parashikuar, Asambleja e Përgjithshme vendos me votën unanime të ortakëve për të gjitha çështjet që mund të prekin parimet e biznesit social, në veçanti Nenin 4.3 të Statutit.
- 11.9 Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme drejtohen nga Kryetari i zgjedhur nga radha e ortakëve ose ndonjë nga ortakët e tjerë të pranishëm. Asambleja e Përgjithshme emëron një sekretar për të mbajtur procesverbalet, i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht ortak.
- 11.10 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të nënshkruhen bashkarisht nga Kryetari dhe sekretari.



Neni 12 – Administratori/ët

- 
- 12.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkarisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 3 (tre) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 12.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 12.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë të posaçme ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.

Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 13.1 Nëse është e nevojshme/kërkohet nga ligji ose vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë kryehet nga një ose disa ekspertë kontabël të autorizuar.
- 13.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni përkatës.

KAPITULLI IV

VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 14 – Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor

- 14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 14.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe përfundon më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.
- 14.3 Asambleja e Përgjithshme miraton bilancin vjetor, pasqyrat financiare, inventarin, raportet e Administratorit/ëve dhe të ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar).
- 14.4 Dokumenta që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

Neni 15 – Fitimet


- 15.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor përdoren në përputhje me vendimin e marrë nga Asambleja e Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, për qëllime të posaçme, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme ose të shtyjë ri-investimin e fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.
- 15.2 Fitimet do të përdoren në përputhje me Objektin e Shoqërisë përcaktuar në Nenin 4 të këtij Statuti dhe në veçanti në përputhje me parimet dhe praktikatat e biznesit social të treguar në Nenin 4.3.

KAPITULLI V

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI

Neni 16 – Shpërndarja

- 16.1 Shoqëria mund të priset me vendim të Asamblesë së Përgjithshme apo në rastet e parashikuara nga ligji.



16.2 Shoqëria nuk priset për shkak të paafësisë për të vepruar, pengesave ligjore, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të ortakëve.

Neni 17 – Likuidimi

- 17.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidues të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar të likuidimit mbi asetet dhe detyrimet e Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme të likuidimit.
- 17.3 Në fund të procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme vendos në lidhje me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/t dhe përfundimin e procesit të likuidimit, si dhe shpërndarjen apo riinvestimin e shumave eventualisht të mbetura pas likuidimit të cilat tejkalojnë kapitalin që ortakët kanë investuar, duke përcaktuar modelitet e nevojshme për këtë qëllim.
- 17.4 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive të maturuara, likuiduesi/t u shpërndajnë ortakëve asetet e mbetura në përputhje me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme marrë në bazë të nenit 17.3 më sipër.

KAPITULLI VI TË NDRYSHME

Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

- 18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve ose midis një apo disa ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore nga palët e interesuara.
- 18.2 Nëse mosmarrëveshja nuk zgjidhet në mënyrë miqësore, ajo i paraqitet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.


Neni 19 – Gjuha

Ky Statut është hartuar në gjuhën Shqipe.


Neni 20 – Dispozitat ligjore në fuqi

Për gjithçka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore në fuqi.


ORTAKU


Znj. Rozina Marku

ORTAKU


Zj. Sonila Marku


ORTAKU


Z. Shkëlzen Marku



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR 119 REP

Taksa e pulles
u likujdua



VERTETIM NENSHKRIMI

Në Tiranë, sot më datë 12.01.2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë), para meje Notere ANILA GJERMENI, anëtare e Dhomes së Noterëve Tiranë, me Adresë zyre në pallatin (në katin e parë), para hyrjes së godinës së Gjykatës Civile të Rrethit Gjyqësor Tiranë u paraqitën

- 1- znj. ROZINA MARKU, lindur më datë 01.07.1972 në Gojan i Vogël, Pukë dhe banuese në Tiranë, në adresën rruga Cercizi Topulli, pallati AK, Shkalla 5/1, mbajtëse e letërnjoftimit nr personal H25701175H,
- 2- znj. SONILA MARKU, lindur më datë 15.09.1996 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, në adresën rruga Cercizi Topulli, pallati AK, Shkalla 5/1, mbajtëse e letërnjoftimit nr personal J65915067S
- 3- z. SHKËLZEN MARKU, lindur më datë 11.07.1969 në Porav-Fierzë, Pukë dhe banues në Tiranë, në adresën rruga Cercizi Topulli, pallati AK, Shkalla 5/1, mbajtës i letërnjoftimit nr personal G9071106F,

Të cilët më deklaruan se bashkëngjitur këtij Vërtetimi është Akt Themelimi dhe Statut (Shtojcë) i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar »AGRIMONA» SHPK, të cilën ata e kanë përpiluar me vullnetin tyre të lirë dhe të plotë jashtë kësaj zyre dhe e nënshkruan në praninë time dhe Unë Noterja e vërtetoj dhe nënshkruaj rregullisht bazuar në ligjin 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" (i ndryshuar)

NOTERE
Anila Gjermeni